



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 506/1 Prot.

Tiranë, më 01 / 04 / 2021

**V E N D I M**

**Nr. 54, Datë 01 / 04 / 2021**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 41, datë 18.03.2021, të F. C kundër: Policisë së Shtetit, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Pogradec, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes shëndetësore<sup>1</sup>” dhe “moshës<sup>2</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>3</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, si dhe bazuar në dokumentacionin bashkëlidhur, subjekti ankues nëpërmjet Vendimit nr. 3, datë 20.04.2005, të Kryetarit të Qarkut Korçë është pajisur me aktin e pronësisë, sipas ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, akt i cili është shoqëruar me akte dhe vendime të Komisionit të tokës së fshatit Leshnicë, sipas ligjit nr. 8312, datë 26.03.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”. Ankuesi ka pretenduar se akti i pronësisë ka dalë bazuar në kartelën e Zyrës së Regjistrimit të Pronave të Paluajtshme (sot ASHK) dhe hartës topografike të Zyrës Pogradec, të cilat vërtetonin se toka ishte tokë- shtet, ndërkohë që mbështetur në ligjin nr. 7501/1991 “Për tokën”, ai duhet të ishte pajisur me çertifikatë pronësie në emër të tij.

<sup>1</sup> Referuar Dëshmisë nr. 794, të lëshuar nga Shoqata e Invalidëve të Punës së Shqipërisë, rezulton se ankuesi është invalid i grupit të dytë.

<sup>2</sup> Ankuesi është i datëlindjes 29.09.1947.

<sup>3</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec me Vendimin nr. 1385-901, datë 06.12.2010 ka vendosur që prona e pretenduar nga ankuesi ka juridiksion territorial, Komunën Çërravë, Pogradec dhe detyrimin e palëve: Komuna Çërravë, Këshilli i Qarkut Korçë dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokave, të njohin këtë fakt. Ky vendim është lënë në fuqi nga gjykata e Apelit Korçë nëpërmjet vendimit nr. 218, datë 17.05.2011.

Ankuesi shprehet se që nga viti 2012 ka aplikuar për marrjen e certifikatës së pronësisë dhe për njohjen e tij si pronar i ligjshëm i pronës, gjë për të cilën pretendon se nuk ka ndodhur pasi është diskriminuar nga ana e Drejtorisë Vendore të ASHK Pogradec dhe Zyra Vendore e Titujve të Pronësisë (ZVTP) Korçë, për shkak të gjendjes shëndetësore dhe moshës së tij.

Nga ana tjetër, subjekti ankues ka pretenduar për diskriminim nga Policia e Shtetit dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pogradec, duke parashtruar se: *“Policia e Shtetit vuri në lëvizje Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Pogradec, duke hedhur idenë e gabuar se janë dy akte pronësie për pasurinë/tokën time”*. Ankuesi ka pretenduar gjithashtu diskriminimin nga Policia e Shtetit edhe për veprimin e kryer prej saj duke shkukur 100 rrënjë pemë dhe 2315 m të mbjella me perime nga toka e tij.

Në përfundim të parashtrimeve, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri hetimin e kësaj çështjeje, regjistrimin e pronës në emër të tij nga DV ASHK Pogradec dhe marrjen e masave për mos eliminimin fizik të tij.

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike

ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, konstatohet se:

Së pari, lidhur me pretendimin e ankuesit për diskriminim nga ana e DV ASHK Pogradec dhe ZVTP Korçë, sa i takon mosdhënies së certifikatës së pronësisë dhe njohjes së tij si pronar i ligjshëm i pronës, Komisioneri vlerëson se:

- Nga verifikimet e kryera rezulton se pretendimet e parashtruara nga ankuesi janë shqyrtuar nga KMD, në kuadër të dy ankesave të mëparshme, për të cilat Komisioneri është shprehur me dy vendimet respektive, si dhe nuk është depozituar asnjë provë apo fakt i ri për të filluar trajtimin e një çështjeje, shqyrtimi i së cilës për më tepër ndodhet jashtë kompetencave që LMD i atribuon Komisionerit. Kështu:
- 1. Nëpërmjet Vendimit nr. 87, datë 05.07.2019, Komisioneri ka vendosur mospranimin e ankesës me nr. regj. 74/2019, pasi ankesa ishte depozituar jashtë afateve ligjore dhe për shkak se *“e drejta për regjistrimin e pronës bën pjesë në kompetencën e ZQRPP ose zgjidhet në rrugë gjyqësore”*.
- 2. Nëpërmjet Vendimit nr. 79, datë 30.07.2020, Komisioneri ka vendosur mospranimin e ankesës me nr. regj. 81/2020, me arsyetimin se e njëta çështje, me të njëjtin objekt, të njëjtat shkaqe të pretenduara dhe kundër të njëjtave subjekte ishte shqyrtuar në kuadër të një ankese të mëparshme të sjellë prej tij dhe se për të ishte dhënë një vendim i mëparshëm dhe nuk kishte të dhëna të reja.

Për sa më sipër, Komisioneri, mbështetur në nenin 33, pika 4/c e LMD, të ndryshuar, i cili përcakton se: *“Ankesa nuk pranohet nëse e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja”*, gjykon se pretendimet e ankuesit për diskriminim nga e DV ASHK Pogradec dhe ZVTP Korçë, nuk mund të pranohen për shqyrtim.

Së dyti, lidhur me pretendimin e ankuesit për diskriminim nga Drejtori i DV ASHK Pogradec, G.M, për faktin se ai ka shpërdoruar detyrën përmes mos pajisjes me certifikatë pronësie të

tokës të F. C, Komisioneri vlerëson se:

- Bazuar në Kallëzimin me nr. 647, datë 19.11.2020 dhe Vendimin “Për mosfillimin e procedimit penal”, datë 23.11.2020 rezulton që këto pretendime janë shqyrtuar nga organi kompetent, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pogradec e cila ka dalë me një vendim lidhur me rastin e hetuar prej saj.
- Komisioneri informon ankuesin se, ankimimi i vendimeve të organeve gjyqësore të tilla si prokuroria apo gjykatat bëhet sipas hierarkisë, në shkallët më të larta të gjykatave respektive dhe shqyrtimi i tyre është jashtë kompetencave të KMD-së.

*Së treti*, lidhur me pretendimin e ankuesit për diskriminim nga Policia e Shtetit për veprimin e kryer prej saj duke shkullur 100 rrënjë pemë dhe 2315 m të mbjella me perime nga toka e tij, si dhe nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pogradec, duke parashtruar se: “*Policia e Shtetit vuri në lëvizje Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Pogradec, duke hedhur idenë e gabuar se janë dy akte pronësie për pasurinë/tokën time*”, Komisioneri vlerëson se, bazuar në dokumentacionin poshtëcituruar, rezulton e provuar se pretendimet e mësipërme ankuesi i ka bërë objekt të kallëzimeve penale, si dhe të shqyrtimi gjyqësor nga organet respektive të cilat janë shprehur me vendimet përkatëse. Kështu citojmë:

- Kërkesën për ndjekje penale drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pogradec, me datë 29.05.2006 të ankuesit ndaj shtetasit A. Sh, për pushtimin e tokës së tij, si dhe për shkulljen e thyerjen e pemëve dhe të mbjellave të tij.
- Vendimin e datës 24.11.2006 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pogradec, dhënë për çështjen në fjalë.
- Vendimin nr. 78, datë 13.06.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, e cila ka si kërkuar Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Pogradec, kundër të pandehurit A. Sh akuzuar për veprën penale të shkatërrimit të pronës ndaj shtetasit F.C, dhe në përfundim ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit A. Sh, për veprën penale për të cilën akuzohet dhe dënimin e tij me 200.000 lekë gjobë.
- Vendimin nr. 605, datë 16.07.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, e cila ka si paditës subjektin ankues, kundër të paditurit A. Sh me objekt kërkimin e dëmshpërblimit për dëmin e bërë në pronën e tij, dhe në përfundim ka vendosur detyrimin e të paditurit A. Sh t’i paguajë ankuesit dëmshpërblim për dëmin e shkaktuar.
- Vendimin nr. 48, datë 14.01.2011 të Gjykatës së Apelit Korçë, i cili ka lënë në fuqi Vendimin nr. 605, datë 16.07.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se pretendimet e subjektit ankues janë bërë objekt i shqyrtimit të organeve të posaçme si prokuroria dhe gjykatat, të cilat kanë hetuar dhe shqyrtuar pretendimet e tij, për të cilat kanë dalë me vendimet përkatëse. Po ashtu, Komisioneri vëren se shqyrtimi i pretendimeve të ankuesit lidhur me vendimarrjen e organit të Prokurorisë nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së, për pasojë nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 33 pika 4/c/ç, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, citon shprehimisht se: ankesa nuk pranohet nëse: “*është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji*”, çështja e parashtruar nuk mund të shqyrtohet më tej, sepse nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Së katërti, lidhur me kërkesën e ankuesit për marrjen e masave nga KMD për mos eliminimin e tij fizik duke pretenduar se ka marrë kërcënime, Komisioneri, informon F. C se, shqyrtimi i një fakti të tillë nuk bën pjesë në kompetencat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Komisioneri i sugjeron atij se mund të ndjekë procedurën ligjore pranë organit të Prokurorisë, i cili në bazë të Kushtetutës dhe ligjit është organi kompetent që ushtron ndjekjen penale në Republikën e Shqipërisë.

Neni 84 i Kodit Penal, sanksionon se: “*Kanosja serioze për vrasje ose për plagosje të rëndë që i bëhet një personi, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit*”.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 20/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/c/ç dhe 10 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I:**

1. Mospranimin e ankesës së shtetasit F. C, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

Fusha: Të mira dhe shërbime  
Shkaqet: Gjendja shëndetësore,mosha  
Lloji i vendimit: Mospranim